REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 2143/5 Prot

Tiranë, më 29.06.2026

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

QENDRËS KOMBËTARE TË TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

TIRANË

Në zbatim të ligjit 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar dhe në përfundim të Programit të Angazhimit të Auditimit nr. 2143/2 prot., datë 29.04.2026, ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të Auditimit, i cili është edhe përfundimi i angazhimit të auditimit në QKTGJ Tiranë.

Gjithashtu, ju informojmë se duhet të hartoni, firmosni dhe dërgoni pranë Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Planin e Veprimit të miratuar nga ana juaj jo me vonë se 30 ditë kalendarike nga marrja e raportit përfundimtar. QKTGJ, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve, si dhe të njoftojë me shkrim Njësinë e Auditimit të Brendshëm mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve deri në fund të muajit Dhjetor të çdo viti.

Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e treguar gjatë procesit të auditimit.

DREJTORI
Gerald XHELILAJ

Adresa: Rruga e Kavajës, Nr 1001, Tirana, Albania. Tel: +355 42376178/ext 72128.www.shendetesia.gov.al

ANEKSI NR. 1 PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

	Progresi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit	Niveli I rëndësisë	Afati i zbatimit
1	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë të marrë masa të menjëhërshme për zbatimin e (dy) rekomandimeve (nr. 4 dhe 8) që nuk kanë gjetur zbatim të lëna nga auditimi i mëparshëm me shkresën nr. 826/2 prot., datë 23.02.2023. Në përfundim, pas Raportit Përfundimtar të Auditimit në Planin e Veprimit (Formati nr. 10), të dërgohet informacion në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për realizimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe konkretisht:	I Ulët	***Afati i zbatimit:*** Për 30 ditë
	Rekomandimi nr. 4. Nëpunësi Autorizues të nxjerrë Urdhër të brendshëm brenda vitit 2023 për inventarizimin e aseteve ku në fletët e inventarizimit të aktiveve të pasqyrohen saktë specifikimet teknike të tyre, (lloji i pajisjes, marka, ngjyra etj). Gjithashtu nga sektori i financës të saktësohet teprica në vlerë 26,808 lekë në llogarinë 218, e cila të reflektohet dhe ne relacionin që është pjesë e pasqyrave financiare (bilanci) i vitit 2023.		***Afati i zbatimit:*** Në fund të vitit 2026
	Rekomandimi nr. 8. Nisur nga fakti që në këtë institucion është duke u implementuar digitalizimi i sistemit dhe		***Afati i zbatimit:*** Për 30 ditë të

	mënyra e rregjistrimit të dhuruesve të gjakut duke filluar nga momenti i dhurimit e deri tek momenti i shpërndarjes së gjakut dhe komponenteve të tij si dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore dhe riparimin në një kohë sa më të shpejtë të difekteve, nga Nëpunësi Autorizues i institucionit të dërgohet shkresë zyrtare në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të shtuar në strukturë **një specialist të IT dhe një Inxhinier Biomedikal.**		dërgohet shkresë në MSHMS
	Sistemi i kontabilitetit dhe pasqyrave financiare		
2	Strukturat menaxhuse nuk kanë nxjerrë Urdhër të brendshëm për ngritjen e komisionit për marjen në dorëzi të aktiveve të dhuruara nga donator të ndryshëm.	I Mesëm	***Afati i zbatimit:*** Në fund të vitit
3	Nga shefi i financës së këtij institucioni, vlera 5,514,157 lekë të pasqyrohet në fund të vitit në pasqyrat financiare (Bilanci) nga llogaria 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" te llogaria 218 "Inventar ekonomik".	I Mesëm	***Afati i zbatimit:*** Në fund të vitit
4	Nga Drejtoria e institucionit në inventarizimin e fundvitit të ngrihen komisionet për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si më poshtë: **a.** Për vlerën 28,837,996 lekë që përfaqësojnë aktive të pa përdorura që nga viti 1996 të vlerësohen dhe të nxiren jashtë përdorimit. **b.** Për pajisjet kompjuterike në vlerën 4,431,525 lekë të cilat janë vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit, të asgjësohen (të nxiren nga përdorimi) referuar në: Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin integruar të mbetjeve", neni 19 dhe 57. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektronike dhe elektrike", në të cilin theksohet se grumbullimi, trajtimi dhe asgjesimi i këtyre mbetjeve kryhet vetem nga subjekte që janë të pajisura me leje mjedisore të kategorise III.1 dhe Licensë të kategorisë III.2.B, të autorizuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Agjencia Kombëtare e Mjedisit). Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 95-114. **c**. Gjithashtu rekomandojmë se gjatë procesit të vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimi përveç komisionit që ngrihet për këtë qëllim të jenë të pranishëm dhe punonjësit me përgjegjësi materiale.	I Mesëm	***Afati i zbatimit:*** Në fund të vitit
5	Nga Nëpunësi Autorizues të ngrihet komisioni i vlerësimit	I Mesëm	***Afati i zbatimit:***

	të gjendjes teknike të automjeteve me specialistë përkatës të fushës dhe në rast të konstatimit të pamundësisë së riparimit dhe kthimit të tyre në gjendje pune, të kryhen të gjitha procedurat ligjore për nxjerjen jashtë përdorimit, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik", i ndryshuar.		Në fund të vitit
6	**a.** Nga Drejtoria e Qendres Kombëtare te Transfuzionit të Gjakut Tiranë të merren masa për të dërguar një specialist për tu trajnuar dhe udhëzuar nga inxhinieret klinike të Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore lidhur me procesin e inventarizimit të pajisjeve që disponon ky institucion. **b.** Nga Sektori Teknik të regjistrohen të gjitha aparaturat mjekësore në sistemin online të informacionit kompjuterik që disponon ky institucion sipas standarteve të vendosura nga Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore, dhe njëkohësisht të plotësohet Formulari i Rregjistrimit të Aparaturave Mjekësore.	I Mesëm	*Afati i zbatimit:* Brenda 30 ditëve
7	Të hartohet gjurma e auditimit për aktivet afatgjata gjendje në magazinë lidhur me nevojat dhe vitin e blerjes; gjendjen aktuale të tyre; dhe përgjegjësitë për mos vënie në përdorim të tyre. Në përfundim në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren vendimet e duhura për transferimin e tyre drejt institucioneve të tjera brenda sistemit; referencë ligjore Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".		*Afati i zbatimit:* Brenda 30 ditëve
	Sistemi i prokurimeve dhe investimeve		
8	Anëtarët e komisionit të blerjes të tregojnë kujdes në argumentimin e nevojës per blerje mallra ose shërbime, ne funksion te aktivitetit te institucionit. Për ç'do proçedurë që do të realizohet të bëhet argumentimin i nevojave per mallra ose shërbime.	I Mesëm	*Afati i zbatimit:* Brenda 30 ditëve
	Sistemi i pagesave (transaksioneve)		
9	Të mbahet një proçesverbal për leximin e numrit të kontatorit ndërmjet operatoreve (Ujësjelles -Kanalizime dhe OSHE) me përfaqësues të QKTGJ në të cilët të shënohen data e kontrollit të çdo kontatori si dhe numratori që shënohet në të. Gjithashtu të kërkohet fatura analitike e telefonit fiks.	I Mesëm	*Afati i zbatimit:* Brenda 30 ditëve
	Sistemi i Pagave		
10	Drejtoria e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	I Mesëm	Brenda 30

	të marrë masa dhe të iniciojë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Drejtoria e Buxhetit) rishikimin e kuadrit rregullator që normon organizimin dhe pagesën e shërbimit 24-orësh në njësitë e transfuzionit të gjakut pranë QSUT-së, me qëllim përshtatjen e tij me legjislacionin aktual në fuqi dhe nevojat reale të shërbimit. Gjithashtu të rishikohet edhe numri i nevojshëm i personelit si dhe mënyra e organizimit të shërbimit, bazuar në analizën e ngarkesës së punës dhe nevojave funksionale të institucionit.		ditëve të dërgohet shkresë në MSHMS

Me përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit është hartuar dhe Plani i Veprimit sipas modelit të formatit standart 13. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit, duhet të plotësohet nga Drejtoria e QKTGJ sipas formatit të rekomanduar nga ana jonë dhe pasi të miratohet nga titullari i institucionit të dërgohet zyrtarisht në DAB, **jo më vonë se 20 ditë pune** nga njohja me Raportin Final të Auditimit.